VENDIM
Nr. 49, datë 21.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“
Vitore Tusha	Anëtare	e “	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e “	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i “	“
Gani Dizdari	Anëtar	i “	“

me sekretare Elta Milori, në datën 17.09.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr.28 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ëngjëll Hysenbegasi, Daniela Cetri, Lindita Lulaj, Isuf Melçani, Mjeser Minarolli, Shkëlqim Minarolli, Luljeta Mulosmani, Fatlinda Selenica, Hysnie Minarolli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zhuli Bregasi, Hektor Bregasi, Viliam Bregasi, bashkia Pogradec.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.255, datë 10.02.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; i vendimit nr.282, datë 09.10.2009, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe i vendimit nr.00-2012-2408, datë 15.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29, 30 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi pretendimet e kërkuesve, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit Ëngjëll Hysenbegasi, etj., dhe subjektet e interesuara Zhuli Bregasi, etj., janë përkatësisht trashëgimtarë ligjorë të vëllezërve Starova. Të dyja palët, me kërkesa të veçanta, i janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), pranë bashkisë Pogradec, duke kërkuar: ***kërkuesit*** - të njihen bashkëpronarë mbi objektin ish-muze dhe një godinë dykatëshe pas tij; ***subjektet e interesuara*** - të njihen pronarë të vetëm mbi këto objekte. Vendimet e KKKP-së, që kanë njohur bashkëpronarë mbi këto objekte trashëgimtarët e dy vëllezërve Starova, janë kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.255, datë 10.02.2005, ka vendosur pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit të KKKP-së Pogradec, si dhe njohjen e pronësisë vetëm për trashëgimtarët e Neki Starovës.

3. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.122, datë 25.05.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.255, datë 10.02.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.317, datë 15.03.2007, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë.

5. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.23, datë 04.11.2008, ka vendosur: shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.122, datë 25.05.2005, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr.317, datë 15.03.2007, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë.

6. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.282, datë 09.10.2009, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr.255, datë 10.02.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2012-2408, datë 15.11.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II
Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese

8. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese. Ata kanë pretenduar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

8.1 Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka gjykuar çështjen me një gjyqtar, ndërkohë që duhej të gjykohej me trup gjykues prej tre gjyqtarësh, pasi vlera e padisë ishte mbi 3 milionë lekë;

8.2 Gjykata e Apelit Korçë, gjatë rigjykimit, nuk ka marrë parasysh urdhërimet e Gjykatës Kushtetuese;

8.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) nuk ka dhënë një vendim përfundimtar për zgjidhjen e çështjes, duke cenuar parimin e arsyetimit të vendimit;

8.4 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi gjendja e bashkëpronësisë është prishur me vendime gjyqësore;

8.5 Është cenuar parimi i paanshmërisë nga Gjykata e Apelit Korçë, duke dhënë një vendim shumë të shpejtë, pas kthimit për rishqyrtim nga Gjykata Kushtetuese.

9. ***Subjektet e interesuara Zhuli Bregasi, Hektor Bregasi dhe bashkia Pogradec*** nuk paraqitën prapësime me shkrim për pretendimet e parashtruara nga kërkuesit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

10. Kërkuesit kanë pretenduar se gjatë procesit gjyqësor, të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosrespektimit të së drejtës së gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të paanësisë, parimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe parimit të sigurisë juridike.

11. Gjykata Kushtetuese, pas marrjes në shqyrtim të pretendimeve, gjatë votimit të çështjes nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj[1], të kërkuar nga neni 133, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 72, pika 1, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

12. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkesa duhet të refuzohet. Në bazë të nenit 74 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesit të paraqesin përsëri kërkesë, në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës; neneve 72, 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur në Tiranë, më 26.09.2013

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha.

[1] Gjyqtarët: Bashkim Dedja, Sokol Berberi dhe Gani Dizdari, votuan për pranimin pjesërisht të kërkesës.
Gjyqtarët: Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj dhe Fatmir Hoxha, votuan për rrëzimin e kërkesës.